



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1098/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 2600 (dymij e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se kandidati për asamble komunale nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë Agron Avdyli gjat heshtjes zgjedhore me datën 19 Nëntor 2017 në ora 02:05 minuta përmes rrjetit social facebook ka shpërndar një fotografi me mbishkrimin “Si gjithmonë me Hajvaline bashkuar të pathyeshëm# Lidhja për Prishtinën. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik LDK thekson se personi në fjalë është një qytetar i zakonshëm, meqenëse nuk ka ndonjë status të ish kandidatit që njihet sipas dispozitave ligjore, i njëjti ka qenë kandidat për asamble rezultati i të cilave është shpallur dhe prandaj postimi i tij nuk mund të konsiderohet si postim i bërë nga një kandidat i LDK-së gjat heshtjes zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se kandidati për asamble komunale nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë Agron Avdyli gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet kandidati për kryetar të komunës së Prishtinës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, ku me këtë veprim ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Ndersa lidhur me pretendimet e subjektit politik LDK se personi në fjalë është nje qytetar i zakonshëm dhe se ka qene nje ish kandidat, Paneli konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që në bazë të nenit 32 par 3, 4 dhe 5 të LZP-së subjektet politike i informojnë anëtarët, mbështetësit e tyre dhe kandidatët rreth dispozitave të këtij kodi, dhe se të njëjtat duhet të ndermarin të gjitha hapat e nevojshme për ti parandaluar nga shkelja e këtij kodi, në të kundërtën ato mbahen përgjegjëse për shkeljen e këtij kodi.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së LDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik LDK është përgjegjëse për veprimet e tij duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL Anr.1098/2017 më datën 21.11.2017.



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.